



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PORTI DETAR SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr.366/1.Prot.

Sarandë, më 27.09.2022

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Zbatimi i projektit, Rikonstruksioni i terminalit te udhëtarëve ”
Procedure_e_Hapur e thjeshtuar-Pune-(elektronike)
(nën kufirin e ulët monetar, për punë publike)

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

42416400-9; 42419510-4; 45000000-7; 45421148-3; 45442180-2; 45453100-8; 45454000-4

Vlera e fondit limit:

8,087,385 (tetët milion e tetedhjetë e shtate mijë e treqind e tetedhjetë e pese)lekë pa tvsh.

Buxheti i shtetit: Likuidimi në dy vite buxhetore: Viti Buxhetor 2022: 2 000 000(me tvsh); Viti Buxhetor 2023: 8 000 000(me tvsh).

entiteti	grupi	kodi insittuc	emri institucionit	kapitulli	program	llog. ekonom	kodi d.thesar	kodi Projekt	2022	2023	titulli projektit
01	6	1006093	Porti Detar Sarande	01	04540	2310000	3731	19AC104	2,000,000	8,000,000	Rikonstruksioni i terminalit te pasagjereve Sarande

REF-43505-09-27-2022

Lloji i procedures:

Bazuar në VKM_RrPP/285, Neni 55 Procedurë e hapur e thjeshtuar

1.Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP.

Afati i dorëzimit të ofertave:

Bazuar në Ligjin Nr.162 dt. 23.12.2020, Neni 49, pika 3:

“3. Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës.”.

Përlllogaritja e fondit limit:

Sipas Projektit: (AVE CONSULTING).

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 4 dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor PORTI DETAR SH.A. SARANDË, ka hartuar procesverbalin “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 82(Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit), dhe Nenin 83, pika 1 dhe 2(a) të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe Nenin 26(Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77(Kërkesat për kualifikim) pika 1/a dhe 2(paragrafi i parë), të LPP;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore në tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën në një nga vitet e periudhës së kërkuar(tre vitet e fundit), duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/”c”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si vijon:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më

sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapacitetit ekonomik dhe financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika "1", të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenin 64, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare6

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2021, lëshuar prej njësive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Neni 39,pika 8, "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në Ligjin nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për QKR", i ndryshuar.

2.2.3. Kopje te vertetuar te bilancit, te konfirmuara me vule prane autoriteteve perkatese (Administrates Tatimore), per vitin 2021.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Neni 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare",pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik":

Pika 4: "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit8".

2.3. Kapaciteti teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Vleresimi do kryhet duke u bazuar ne:

-Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipa shtojces nr.9 te DST.

-Situacionin perfundimtar

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

në nenin 39, pika 4 dhe 5, (Kërkesa të veçanta për kontratat e punëve), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues ose distributori i autorizuar, duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për:

Çertifikatë Cilësie ISO 9001:2015 (Sistemi menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79(Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor), të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 dhe nenin 44(Kërkesat e cilësisë) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të kësaj kërkesë, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën. Përmbyllja e standardit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për mallrat e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbylljen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në licencën e shoqërisë:

NP-3 A:	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada.
NS-1A	Punime për prishjen e ndertimeve
NS-2A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavyer, mirëmbajtja e tyre
NS-3 A:	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensore, shkallë levizëse, transportues).
NS-4A	Punime rifiniture të muratave, rifiniture me materiale druri, plastik, xhami, dhe të natyrës teknike të ndërtimit.

Argumentimi: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021, Neni 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike), pika 6/a:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

2.3.4. Staf i teknik i Shoqërisë të ketë në përberje, dhe të deklaruar si drejtues teknik :

Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)

Inxhinier Mekanik 1 (nje)

Inxhinier Elektrik/Elektronik 1(nje)

Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të (diploma etj), kontratat e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla.

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mesipër, duhet të jetë i pasqyruar në Listëpagesat, prej një periudhe jo më pak se 2 muaj.

Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të (diploma etj) e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla.

Argumentimi: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021, Neni 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike), pika 6/c:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj.

2.3.5. OE ofertues duhet të ketë numrin minimal të nevojshëm prej 20 punonjesh, prej një periudhe jo më pak se 2 (dy) muaj, të vertetuar. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen në formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Argumentimi: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021, Neni 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike), pika 6/ç:

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Bazuar në dokumentin e paraqitur nga projektuesi “AVE CONSULTING, me titullin “Raport teknik-Specifikimet teknike”.

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik në formatin PDF.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, parashikimet e Nenit 4, pika 38/b dhe Nenit 36(Specifikimet teknike), të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Nenit 39(Kërkesa të veçanta për kontratat e punëve), pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

REFERENCA TEKNIKO-LIGJORE PER SPECIFIKIME;

- **Projekti(AVE CONSULTING)**

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit:

Krenar Bedaj Kryetar

Florjana Jerondati Anëtar

Thoma Thomagjini Anëtar

SEKSIONI III

KËRKESA TË VEÇANTA SIPAS TIPEVE TË KONTRATAVE

Neni 39

Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike

1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të

~~ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.~~

Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

b) me kontratë me çelësa në dorë:

i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

3. Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pes ë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pes ë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

37

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni I fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) Operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) Operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me vlerën totale të përllogaritur të kontratës/ave.